REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-573
Data/Datum/Date: 24/04/2026
Shtojca/Dodaci/Annex: -1-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Drejtësisë – Ured Ministra Pravde – Office of the Minister of Justice

Nr. 63 /2026
Datë: 23 /04/2026

Ministrja e Drejtësisë, në mbështetje të nenit 10 paragrafi 2 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 11 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, dhe duke u bazuar në nenin 63 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nxjerr:

V E N D I M

1. Z. Ridvan Hoti, Zëvendës Drejtor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, transferohet përkohësisht për interes të institucionit në kategorinë e njëjtë në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë.

2. I transferuari sipas pikës 1 të këtij vendimi, kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për një periudhë 6 mujore përkatësisht deri më 24.10.2027.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë ka mbetur e lirë për shkak se Sekretarja e Përgjithshme është transferuar në institucion tjetër. Për të siguruar vazhdimësinë institucionale, funksionimin e rregullt dhe ushtrimin pa ndërprerje të kompetencave të Sekretarit të Përgjithshëm, është e nevojshme plotësimi i përkohshëm i kësaj pozite deri në përfundimin e procedurës.

Duke pasur parasysh interesin e institucionit, nevojën për sigurimin e ushtrimit të vazhdueshëm të funksioneve drejtuese dhe faktin se z. Ridvan Hoti aktualisht është i emëruar në pozitën e nivelit të lartë drejtuese, përkatësisht i përket së njëjtës kategori, deri në përfundimin e procedurës së rekrutimit dhe emërimin e Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi, u vendos transferimi i përkohshëm i tij në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të MD-së, për periudhën e përcaktuar në diapozitivin e këtij vendimi.

Donika GËRVALLA - SCHWARZ

Ministre e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:
- *Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MD-së;*
- *Të gjitha njësive organizative të MD-së;*
- *Arkivit të MD-së.*